

Vendim nr. 235 datë 16.10.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj,	Kryetare
Marsida Xhaferllari,	Anëtare
Marjana Semini	Anëtare

në datën 16.10.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 13 (K) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUES: **KASTRIOT DERVISHI**, përfaqësuar nga avokate Etleva Haka, me akt përfaqësimi.

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. 54, datë 25.05.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat; nr. 201, datë 21.09.2001 të Gjykatës së Apelit Vlorë; nr. 00-2014-916, datë 19.06.2014 të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.
Kthimi i çështjes për rigjykim në Gjykatën e Shkallës së Parë Berat, me tjetër trup gjykues.

BAZA LIGJORE: Neni 18 pika 1, 42, 43, 44, 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 5, 6, pika 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat Njeriut; ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Marjana Semini, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuesi Kastriot Dervishi, me vendimin nr. 54, datë 25.05.2001 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat është deklaruar fajtor, në mungesë, për kryerjen e veprave penale “Vrasja me paramendim”, ndaj shtetasve A.D. dhe A.D. dhe, bazuar në nenin 78, pika 2, të Kodit Penal (KP), është dënuar për secilën vepër penale me 20 vjet burgim; “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, të parashikuar nga neni 278, pika 2, i KP-së, është dënuar me 2 vjet burgim; në përfundim, në aplikim të nenit 55 të KP-së, është dënuar me 25 vjet burgim. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim mbrojtja e kërkuesit, e zgjedhur nga familjarët e tij, dhe me vendimin nr. 201, datë 21.09.2001, Gjykata e Apelit Vlore ka lënë në fuqi vendimin e gjykatës së shkallës së parë.

2. Kërkuesi është arrestuar në datën 07.03.2012, ndërsa në datën 15.03.2012, mbrojtja e tij, F.L., ka paraqitur kërkesë për rivendosjen në afat të së drejtës së ankimit/rekursit, të parashikuar nga neni 147, pikat 2 dhe 3, të Kodit të Procedurës Penale (KPP) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat, e cila, me vendimin nr. 63, datë 12.04.2012, ka vendosur pranimin e saj.

3. Në datën 17.04.2012, mbrojtja e kërkuesit ka paraqitur rekurs kundër vendimit nr. 201, datë 21.09.2001 të Gjykatës së Apelit Vlorë dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2014-916, datë 19.06.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit, bazuar në nenin 433 të KPP-së, me arsyetimin se ai nuk përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të po këtij kodi.

4. Në datën 26.08.2024 kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me ankim Kushtetues individual, sipas objektit të tij.

II

Pretendimet e kërkuesit

5. **Kërkuesi**, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i është cenuar *e drejta për proces të rregullt ligjor*, e garantuar nga neni 42 i Kushtetutës, në drejtim të:

- 5.1. *Së drejtës për t'u dëgjuar dhe për t'u mbrojtur*, pasi kërkuesi nuk ka qenë i pranishëm në asnjë fazë të gjykimit në dy gjykatat e faktit dhe nuk ka gëzuar asnjëherë të drejtën për t'u dëgjuar. Në momentin kur iu krijua mundësia për t'u dëgjuar gjatë procesit të shqyrtimit të rekursit në Gjykatën e Lartë, ajo gjykatë e ka shqyrtuar rekursin në dhomë këshillimi dhe ka vendosur mospranimin pa dhënë asnjë shpjegim, fakt ose analizë për arsyet se përse kjo çështje kaloi në dhomë këshillimi. Po kështu mungon regjistrimi audio i gjykimit në dhomë këshillimi (sipas udhëzimit nr. 353/2013 të ministrit të Drejtësisë dhe neneve 115 dhe 177 të KPP-së). Kërkuesi deri në muajin

korrik të vitit 2024 nuk ka pasur dijëni se ndaj tij është zhvilluar ndonjë proces gjyqësor për më tepër për orën dhe datën e shqyrtimit të rekursit ose të ketë pasur kopje të tij.

- 5.2. *Së drejtës së aksesit*, pasi kërkuesi nuk është njoftuar për akuzën. Po kështu, që të merrej vendimi për gjykimin në mungesë, gjykata duhej që, bazuar në nenet 141 dhe 142 të KPP-së, fillimisht të kishte dalë me vendim për mosgjëtyjen e të pandehurit, duke respektuar procedurën përkatëse. Duke u gjykuar në mungesë, atij i është mohuar e drejta për të përfituar nga gjykimi i shkurtuar, i parashikuar në nenin 403 të KPP-së.
- 5.3. *Standardit të arsytimit të vendimeve gjyqësore*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është i paarsyetuar dhe nuk i jep asnjë përgjigje shkaqeve të rekursit. Në vendimin e gjykatës së shkallës së parë edhe pse është kërkuar gjykimi i shkurtuar nuk është arsyetuar nga gjykata në lidhje me të. Në rekurs janë ngritur pretendime për shkelje të rënda procedurale, pra rekursi përmbante shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 432 të KPP-së. Sipas pikës 2 të këtij neni, mospranimi i rekursit në dhomë e këshillimi vendoset për ato rastet kur shkaqet nuk parashikohen nga ligji.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. Për legjitimitimin e kërkuesit

6. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik subjekt i së drejtës, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuara në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

7. Si bartës i të drejtave dhe lirive themelore të parashikuara nga Kushtetuta, kërkuesi, si individ, legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika

1, shkronja “i”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

8. Lidhur me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe nenit 71/a, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 8577/2000, konstatohet se kërkuesi i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual, pasi ka shteruar mjetet e ankimit në formë dhe substancë ndaj vendimeve të gjykatave më të ulëta, për rrjedhojë ai nuk ka mjet tjetër ankimi përveç atij kushtetues individual.

9. Për legjitimimin *ratione temporis*, Kolegji vëren se për ankimet kushtetuese individuale të paraqitura pas datës 01.03.2017, sipas nenit 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000 dhe nenit 86, pika 3, të ligjit nr. 99/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8577/2000”, afati është shkurtuar nga 2 vjet në 4 muaj nga konstatimi i cenimit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual.

10. Në rastin konkret, Kolegji vëren se vendimi më i fundit, i cili ka përmbyllur procesin gjyqësor të zhvilluar ndaj tij, ai i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, është i datës 19.06.2014, kurse ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 26.08.2024, pra dukshëm jashtë afatit ligjor 2-vjeçar, të përcaktuar në nenin 30, pika 2, të ligjit nr. 8577/2000, para ndryshimeve me ligjin nr. 99/2016.

11. Për sa i përket përmbushjes së këtij kriteri, Kolegji vëren se kërkuesi pretendon se ankimi kushtetues individual është depozituar brenda afatit ligjor 4-mujor nga data e marrjes dijeni për vendimin e kundërshtuar nëpërmjet shkresës nr. prot. 3363/1, datë 03.07.2024 të Gjykatës së Lartë. Sipas tij, marrja e kësaj përgjigjeje përbën momentin e fillimit të afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual.

12. Po kështu, Kolegji konstaton se kërkuesi është arrestuar në datën 07.03.2012 dhe nëpërmjet aktit të përfaqësimit të datës 13.03.2012, të nënshkruar prej tij, i ka dhënë tagrat e përfaqësimit në të gjitha shkallët e gjykimit avokatit F. L. Në datën 15.03.2012, ky përfaqësues ligjor ka paraqitur kërkesë për rivendosje në afat të së drejtës së ankimit/rekursit. Në lidhje me shqyrtimin e kësaj kërkesë, kërkuesi rezulton se është vënë në dijeni nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, për datën dhe orën e gjykimit. Pasi kjo kërkesë është pranuar nga Gjykata e Rrethi Gjyqësor Berat, sërish kërkuesi, nëpërmjet mbrojtësit F.L., ka ushtruar të drejtën e rekursit për çështjen e themelit, për të cilën Kolegji Penal ka dhënë vendimin e datës 19.06.2014.

13. Për sa më sipër Kolegji vëren se ka qenë kërkuesi i cili ka nisur procesin gjyqësor të rivendosjes në afat e në vijim të ushtrimit të rekursit, për përfundimin e të cilit ka qenë i interesuar.

Në këto kushte, pretendimi i tij se ka marrë dajeni për vendimin e Kolegjit Penal në vitin 2024, pra 10 vjet më pas, është haptazi i pabazuar.

14. Për rrjedhojë, në lidhje me këtë pretendim, Kolegji vlerëson se ai është paraqitur jashtë afatit ligjor, të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

15. Në përfundim, Kolegji çmon se kërkesa nuk përmbush kriteret ligjore për kalimin e saj për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronjat “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.